

PROF. EMILIO PICCIONE
Profesor Emeritus në Gjinekologji dhe Obstetrikë

Emilio Piccione lindi në Messina, Itali, më 22 mars 1951.

U diplomua në Mjekësi dhe Kirurgji me rezultatin shkëlqyeshëm në vitin 1975 në Universitetin e Romës "La Sapienza" dhe përfundoi Specializimin në Obstetrikë dhe Gjinekologji me rezultatin shkëlqyeshëm në vitin 1980.

Fitues i një burse nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane në Tods Gynekoloska Klinik, Qendra Klinike Universitare, Ljublianë (Slloveni) në vitin 1981. *Visiting Fellow*, "Centers Hospitaliers Universitaires", l'Assistance Publique Francaise de Paris (Faculté de Medecine Saint Atoine Chaire d'Obstetrique, Paris VI) në vitin 1981 dhe Lyon et Strasbourg, (1982-1984).

Profesor me kontratë në Endokrinologji Obstetrike, Shkolla e Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë, 1983/84 në vijim **Kërkues shkencor** në universitet në Gjinekologji dhe Obstetrikë, 1984-1988 dhe në vijim Profesor i Asociuar në Patologji Obstetrike dhe Gjinekologjike gatë viteve 1988-1990. Profesor i Patologjisë Obstetrike dhe Gjinekologjike, Universiteti i Studimeve Cagliari 1990-1994, Profesor në Endokrinologji Gjinekologjike, 1994-2001 dhe në Gjinekologji dhe Obstetrikë 2001-2021 në Universitetin e Romës Tor Vergata, Departamenti i Biomjekësisë dhe Parandalimit. Në të njëjtin universitet ka qenë Drejtues i programit të studimit në Obstetrikë, Drejtor i programit të Specializimit në Gjinekologji dhe Obstetrikë, Koordinator i programit të Doktoratës në "Shkencat e strukturës së legenit femëror", Zëvendësdrejtor i Departamentit Universitar të Biomjekësisë dhe Parandalimit. Ka qenë Drejtor i Klinikës Obstetrike dhe Gjinekologjike të Universitetit të Romës Tor Vergata në Spitalin S. Eugenio në Romë, nga viti 1999 deri në vitin 2003, dhe shef i njësisë së gjinekologjisë në Spitalin Universitar Tor Vergata, nga viti 2003 deri në vitin 2021. Pedagog në "Menaxhim Spitalor" dhe "Epidemiologji" në Shkollat për Qëllime të Veçanta (1983-1985) dhe Pedagog në Kursin Pasuniversitar në "Bioetikë dhe Bio e Drejta" (2013) të të njëjtit Universitet. Në vitin 2018 ka përfunduar Masterin e nivelit të 2-të në "Ekonomi dhe Menaxhim në Kujdesin Shëndetësor", në Universitetin e Romës Tor Vergata, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Ekonomisë dhe Financës. Nga viti 2018 deri në vitin 2021 ka qenë Drejtor i Departamentit të Asistencës Klinike me aktivitet të integruar të Shkencave Kirurgjikale të Poliklinikës Universitare Tor Vergata në Romë. Anëtar Themelues (2001) dhe Koordinator i Forumit të Përhershëm të Kirurgjisë Gjinekologjike të Universitetit të Romës Tor Vergata. Nga viti akademik 2017/2018 është Profesor me kontratë në Gjinekologji dhe Obstetrikë në programin e studimit në Mjekësi dhe Kirurgji dhe nga viti akademik 2018/2019 Drejtor i Programit të Specializimit Afatgjatë në Gjinekologji dhe Obstetrikë të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë (Shqipëri).

Aktiviteti i gjerë shkencor me kalimin e kohës ka pasur gjithashtu bashkëpunime zyrtare ndëruniversitare me grupe të njohura kërkimore evropiane, skandinave dhe të Amerikës së Veriut.

Linjat kryesore të kërkimit shkencor kanë të bëjnë, në veçanti, me rolin e faktorëve lokalë endokrinë dhe parakrinë në lidhje me kontrollin e mekanizmit të lindjes tek qenia njerëzore, nga njëra anë, dhe aspektet fiziopatologjike dhe klinike të abortit spontan të përsëritur, nga ana tjetër, kanë qenë objekt publikimesh në revista periodike ndërkombëtare të sektorit (të disponueshme në faqen e internetit pubmed.com) dhe janë cituar gjerësisht dhe vazhdimisht në literaturën referente me kalimin e kohës (*h*-indeksi total = 24). E përhapur ishte edhe veprimtaria botuese në fushën gjinekologjike dhe obstetrike, posaçërisht për studentët universitare dhe mjekët në trajnime të specializuara. Aktualisht është *Reviewer* i revistave shkencore ndërkombëtare më të njohura të Gjinekologjisë dhe Obstetrikës dhe *Referee* i pavarur i jashtëm për Universitetin Katolik të Louvain (Belgjikë) me qëllim vlerësimin e projekteve kërkimore të planifikuara me financim qeveritar. Si pjesë e veprimtarisë shkencore të shoqërisë, është Anëtar Themelues i Shoqatës Evropiane për Kërkime Shkencore në Gjinekologji dhe Obstetrikë, ESGOI (1983), Anëtar Nderi i Shoqatës Ndërkombëtare të Disfeksioneve të Legenit Femëror (që nga viti 1986). Themelues (1993) dhe President (2002-2004) i Shoqatës Italiane Placenta (AIP), President i Shoqatës Italiane për Psikosomatikën në Obstetrikë dhe Gjinekologji (SIPGO, 2002-2004).

Që nga viti 1992 e deri më sot është anëtar i Regjistrimit të Mjekëve Ekspertë të krijuar pranë Këshillit Mjekësor të Kongregatës së Shenjtë për Kauzat e Shenjtorëve, Selia e Shenjtë, për studimin e mrekullive që i atribuohen ndërmjetësimeve të Shërbëtorëve të Perëndisë.

Nga data 1 prill 2021, Prof. Emilio Piccione, me urdhër emërimi nga ministria, mori titullin **Profesor Emeritus i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës**, në Departamentin e Shkencave Kirurgjike të Universitetit të Romës Tor Vergata.